

AKT-THEMELIMI

AKT - THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AL-TEK" SHPK



Në mbështetje të ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", unë i nënshkruari Altin Bakullari, shtetas shqiptarë, si themelues e ortak i vetëm i Shoqërisë Tregtare, sot me datë 14.02.2005, me zotësi ligjore për të vepruar,

VENDOSA

Të themeloj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "AL-TEK" shpk.

**Neni 1
FORMIMI**

Formohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin SHOQËRIA TREGTARE "AL-TEK" SHPK, me ortak të vetëm themelues: Altin Bakullari, i biri i Thomait, datëlindja 06.06.1969, lindur në Gjirokastër dhe banuese në Tiranë në adresën rruga: "Arkitekt Sinani, pallati 10, ap, 27me letërnjoftim nr.NF046349.

**Neni 2
SELIA**

Shoqëria "AL-TEK" SHPK ka selinë e saj në lagjen: "Besëlidhja", pallati 75, Lezhë.

**Neni 3
KOHËZGJATJA**

Shoqëria "AL-TEK" SHPK ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj të pakufizuar.

**Neni 4
OBJEKTI I VEPRMTARISË**

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë "AL-TEK" SHPK është sa vijon:

- tregtimi i mallrave të ndryshëm me shumicë dhe pakicë në natyrën e lëndëve të para, produkteve të gatshme apo gjysëm të gatshme, ushqimore, industriale, makinerive, pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, aspiruese, të të gjitha llojeve, teknilogjive, etj,

Shoqëria Tregtare "AL-TEK" shpk

AKT-THEMELIMI

- 
- kryerja e çdo lloj operacioni dhe transaksioni në lidhje me importimin eksportimin, transportimin e mallrave të ndryshëm, lëndëve të para, produkteve të gatshme apo gjysëm të gatshme, ushqimore, industriale, makinerive, pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, aspiruese, të gjitha llojeve, teknologjive, etj,
 - ushtrimi i veprimtarimisë së projektimit, prodhimit, montimit, riparimit, transportimit të pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, aspiruese, të gjitha llojeve, teknologjive, administrimi i tyre duke përfshirë operacionet e shitjes, qirasë, shërbimeve të ndryshme për pajisjet e lartpërmendura,
 - ushtrimi i veprimtarimisë së prodhimit, montimit, riparimit, transportimit dhe shitjes së mobilerive të gjitha llojeve.
- si dhe cdo veprimtari tjetër të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimeve të objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i Shoqërisë "AL-TEK" Sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i investuar në masë të plotë prej pronarit, ortakut të vetëm Altin Bakullari.

Ky kapital ndahet në pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave është 1000 (njëmijë) lekë.

Neni 6 ORGANET DREJTUESE

Shoqëria "AL-TEK" SHPK drejtohet nga z. Altin Bakullari, si Administrator i Vetëm dhe përfaqësues i Shoqërisë.

Si ortak i vetëm, Administratori gëzon të gjitha të drejtat e Asamblesë së Shoqërisë.

Neni 7 VULA

Shoqëria ka vulën e saj, me përmbajtje SHOQËRIA "AL-TEK" SHPK

Neni 8 DISPOZITA TË FUNDIT

Dispozita për mardhëniet e punës, kontrolli i brendshëm, mbajtja llogarive e përdorimi i fitimit, të sekretit të punës dhe të shpërbërjes së Shoqërisë trajtohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë, që është pjesë përbërëse e këtij Akti.

Shoqëria Tregtare "AL-TEK" shpk

AKT-THEMELIMI

Neni 9

Akti Themelues përpilohet në disa kopjo për t'iu shpërndarë organeve kompetente : Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për regjistrimin si person juridik dhe regjistrimin në regjistrin tregtar pranë kësaj gjykate; Organit përkatës tatimor për regjistrimin si subjekt privat dhe një kopjo mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë " AL-TEK " SHPK

Akti Themelues hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij dhe i firmosur rregullisht nga ortakut i vetëm, Administrator i Shoqërisë.

ORTAKU I VETEM

Altin Bakullari



Shoqëria Tregtare "AL-TEK" shpk

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "AL-TEK" SHPK.



Neni 1 FORMIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "AL-TEK" SHPK, është themeluar në bazë të Aktit Themelues të datës 14.02.2005, të nënshkruar nga ortaku i vetëm z. Altin Bakullari, i biri i Thomait, datëlindja 06.06.1969, lindur në Gjirokastrë dhe banuese në Tiranë, në adresën rruga: "Arkitekt Sinani, pallati 10, ap, 27", me letërnjoftim nr.NF046349.

Neni 2 EMËRTIMI DHE VULA

Shoqëria do të ketë emërtimin : "AL-TEK" SHPK.
Shoqëria ka vulën e saj, me përmbajtje SHOQËRIA "AL-TEK" SHPK.

Në të gjitha aktet ose dokumentat e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve duhet të figurojnë këto emërtime dhe emri i administratorit.

Neni 3 SELIA

Shoqëria "AL-TEK" SHPK ka selinë e saj në lagjen: "Besëlidhja", pallati 75, Lezhë.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë vendqendrimet të tjera të dyta operative, filiale, përfaqësi e agjensi brenda dhe jashtë vendit, me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 4 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë "AL-TEK" SHPK është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Neni 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë " AL-TEK " SHPK është sa vijon:

- tregtimi i mallrave të ndryshëm me shumicë dhe pakicë në natyrën e lëndëve të para, produkteve të gatshme apo gjysëm të gatshme, ushqimore, industriale, makinerive, pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, aspiruese, të të gjitha llojeve, teknologjive, etj,
- kryerja e çdo lloj operacioni dhe transaksioni në lidhje me importimin eksportimin, transportimin e mallrave të ndryshëm, lëndëve të para, produkteve të gatshme apo gjysëm të gatshme, ushqimore, industriale, makinerive, pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, aspiruese, të të gjitha llojeve, teknologjive, etj,
- ushtrimi i veprimtarimisë së projektimit, prodhimit, montimit, riparimit, transportimit të pajisjeve ngrohëse, ftohëse, kondicionuese, sistemeve aspiruese, të të gjitha llojeve, administrimi i tyre duke përfshirë operacionet e shitjes, qirasë, shërbimeve të ndryshme për pajisjet e lartpërmendura,
- ushtrimi i veprimtarimisë së prodhimit, montimit, riparimit, transportimit dhe shitjes së mobilerive të të gjitha llojeve.

si dhe cdo veprimtari tjetër të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimeve të objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e saj, sipas vendimeve që do të marrë ortaku i vetëm, Administratori i Shoqërisë zAltin Bakullari.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë " AL-TEK " Sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i investuar në masë të plotë prej pronarit, Ortakut të vetëm dhe Administrator z.Altin Bakullari.

Ky kapital ndahet në pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave është 1.000 (njëmijë) lekë.

Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve që do të marrë ortakut të vetëm, Z. Altin Bakullari.

Neni 9

Shoqëria merr përsipër detyrimet kontraktore e jashtëkontraktore brenda kapitalit të saj themelor. Ortaku i vetëm bart rrezikun për veprimtarinë ekonomike të shoqërisë dhe detyrimet ndaj të tretëve, brenda kapitalit të saj themelor, duke mos u përgjigjur për këto detyrime me pasuri të fituara në aktivitete të tjera ekonomike, jashtë kësaj shoqërie.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

**Neni 10
DREJTIMI**

Shoqëria Tregtare "AL-TEK" SHPK është pronë e ortakut të vetëm z. Altin Bakullari, i cili gëzon të gjitha atributet e Asamblesë së Shoqërisë.

Ortakut merr vendime në lidhje me:

- miratimin e llogarive vjetore;
- caktimin e rezultatit financiar;
- emërimin e administratorit;
- emërimin e ekspertit kontabël;
- zmadhimin, zvogëlimin ose transferimin e pjesëve të kapitalit,
- ndryshimin e objektit;
- prishjen e shoqërisë, etj.

Ortakut ka të drejtë të marrë çdo vendim tjetër, të nevojshëm dhe të dobishëm për drejtimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Kompetencat e ortakut të vetëm për vendimet që i përkasin asamblesë nuk mund t'i delegohen askujt tjetër.

**Neni 11
ADMINISTRIMI**

Ortakut të vetëm është edhe Administrator i Shoqërisë Tregtare "AL-TEK" SHPK.

Ortaku i vetëm mund të emërojë një a më shumë persona të tjerë si administratorë të Shoqërisë.

Administratori qëndron në këtë funksion për periudhën që është përcaktuar në aktin e emërimit, përveç rasteve të dorëheqjes ose të revokimit në çfarëdo kohe nga ana e tij.

Administratori merr vendime në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të këtij Statuti të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut.

Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për detyrimet që janë brenda kompetencave të tyre.

Neni 12

Administratori ka kompetencat si vijon :

- kontakton e hyn në marrëveshje me shoqëritë e tjera tregtare;
- kryen çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore apo private që kanë të bëjnë me garancitë apo veprime hipotekore,
- kryen veprime depozitimi, kreditimi, pagesa e arkëtime,
- kryen blerje, shitje për interes të shoqërisë,
- lëshon prokura të veçanta për akte të përcaktuara ose kategori aktesh, duke i dhënë përfaqësuesit të autorizuar pushtetin e nevojshëm për arritjen e qëllimit të autorizimit.
- zhvillon aktivitet marketingu në çdo sektor tjetër, veprimtari ndërmjetësimesh, studimesh, bashkëpunimi e programimi, për të zhvilluar nisma ekonomike për llogari të të tretëve.
- marrin pjesë në ankande private e publike, si dhe i besojnë detyra të veçanta profesionistëve të kualifikuar. Në raste të tilla administratori është i detyruar të njoftojë e t'i japë llogari ortakut të shoqërisë.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 13

Marrëdhëniet e punës në Shoqërinë Tregtare rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen me kontratë pune zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Punës.

Neni 14

Të punësuarit në Shoqërinë Tregtare përgjigjen sipas ligjit dhe këtij Statuti për moszbatimin e detyrave dhe për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë Tregtare.

Neni 15

SEKRETI NË PUNË

Të gjithë të punësuarit në Shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së kësaj shoqërie, detyrë kjo që duhet respektuar edhe pas largimit të të punësuarit nga kjo shoqëri.

Neni 16

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Përfaqësimi i Shoqërisë Tregtare "AL-TEK" SHPK i përket Administratorit, i cili ka të drejtë të delegojë një ose disa kompetenca, si dhe personave të autorizuar prej tij.

Neni 17

KONTROLI I BRENDSHËM

Për kontrollin e veprimtarisë së Shoqërisë ortaku emëron një ose disa ekspert kontabël të autorizuar.

Ekspertët kontabël të autorizuar, emërohen për çdo vit ushtrimor. Funksionet e tyre përfundojnë pas miratimit të llogarive vjetore nga ortaku.

Ekspertët kontabël të autorizuar janë të riemërueshëm për një periudhë prej 6 vitesh financiar.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 18

Veprimet ekonomiko financiare të Shoqërisë fillojnë me datën 1 janar dhe mbarojnë me datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Shoqëria për ushtrimin e aktivitetit të saj krijon fondet e nevojshme si dhe fondin rezerve e fondet për zhvillim. Përbërja, madhësia e tyre, burimet e krijimit, përdorimi e rregullimi i tyre bëhet në përputhje me rrethanat, interesat

dhe objektin e shoqërisë, vendosen nga ortaku dhe administratori duke respektuar dispozitat për katëse në fuqi.

Administratori nxjerr bilancin kontabël me llogarinë rezultative Humbje - Fitime, inventare dhe raportin përkatës mbi administrimin, bazuar mbi ligje e rregulla të mbajtjes së kontabilitetit e dokumentacionit përkatës.

Bilanci vjetor miratohet brenda 31 Marsit nga ortaku i vetëm, duke vendosur me këtë rast edhe krijimin e fondeve të ndryshme si fondi rezerve, të akumulimit, etj. Për rezerva financiare caktohen 5% të fitimit derisa ky fond të arrijë 10% të kapitalit themelor. Pas këtij niveli kuota e rezervimit është e lire.

Neni 19

Pasuria e Shoqërisë është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

Neni 20

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Shpërndarja e Shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si humbje e kapitalit, forca madhore, pamundësi veprimtarie, por gjithnjë me vendim të ortakut të vetëm të Shoqërisë.

Neni 21

LIKUJDATORI

Ortaku i vetëm i Shoqërisë vendos mbi mënyrat e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatore duke i përcaktuar detyrat.

Likujdatori është përgjegjës për veprimet e likujdimit të Shoqërisë.

Ai ka të drejtë të shesë pasurinë e shoqërisë, të likujdojë në rradhë të parë detyrimet që shoqëria ka ndaj personave të tretë fizike e juridike. Kapitali i mbetur i kalon ortakut të vetëm i cili miraton veprimtarinë e mbylljes së Shoqërisë dhe kryen veprimet e çrregjistrimit të shoqërisë nga Regjistri Tregtar i Gjykatës.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 21

Për rastet që nuk është shprehur plotësisht në këtë Statut, do t'i referohen ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotësimet e këtij Statuti bëhen me të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën nxirret vetë Statuti, sikurse kërkohet edhe nga ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligji nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

Çdo ndryshim në nenet e këtij statuti nuk prek personalitetin juridik të Shoqërisë.

Neni 22

Ky Statut hartohet në disa kopjo për t'iu shpërndarë organeve përkatëse, bashkë me Aktin e Themelimit të Shoqërisë : Gjykatës për njohjen si person juridik dhe regjistrimin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës, sektorit të tatimeve për regjistrimin si subjekt privat dhe një kopjo mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare "AL-TEK" SHPK.

Statuti firmoset rregullisht nga ortaku i vetëm i Shoqërisë dhe Administrator i saj.

ORTAKU I VETËM

Altin Bakullari



Tirane, me 14.02.2005